

EASY_ART

FINITURË DEKORATIVE PËR BRENDA ME EFEKT METALIK

seri 381

PËRSHKRIMI

EASY_ART krijon sipërfaqe shkëlqyese dhe ekskluzive, ideale në ambientet moderne, gjithashtu I rrit vlerat edhe arredimit të stilit klasik. Për ambiente unike, të kuruar në detajet minimale.

Finiturë akrilike ekstremisht e lehtë për aplikim që siguron gjithmonë efekte dekorative të shkëlqyera dhe të këndshme në prekje. Ideale për personalizimin e sipërfaqeve të ndryshme: mure, dru, plastikë duke përcaktuar atmosferën me energji.

ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

- Suvatime të reja dhe të vjetra.
 - Sipërfaqe betoni.
 - Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.
 - Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
 - Sipërfaqe me natyrë minerale me kusht që të jenë absorbuese.
 - Sipërfaqe druri, laminato(truciolare), kompensata dhe të ngjashme.
 - Sipërfaqe në material plastik (PVC)
- Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin "Përgatitja e sipërfaqes".
Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta (të sapo lyera)
Për të shtuar mbrojtjen e EASY_ART mund të aplikoni 1-2 shtresa DECORFILM LUCIDO kod. 3740230.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e lidhësit: kopolimer akrilik në emulsion ujor.
- Pigmentë dhe komponentët: cariche iridescenti(mbushësa/komponentë iridishente)
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: 1,15-1,25 kg/l
- Viskoziteti I paketimit: 26400 ± 2400 cps
- Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 1 ore; shtresa tjetër pas 4 orësh

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqe në suva, gips dhe kartonxhes:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e thatë mirë dhe e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222. Lajeni me ujë të bollshëm dhe aplikoni detergjentin

COMBAT 333 kod. 4810333. Nëse është e nevojshme shtojini produktin higjienizuesin COMBAT 444 kod. 4810444.

-Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës traspirante/tempera.

-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.

-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, çarjet në sipërfaqe me TAMSTUCCO 9400006/9410110 ose WALL STUCCO 9100019. Mbyllni çarjet me ngjitës (stuko) të përshtatshëm.

-Zmeriloni stukimet me letër zmerile.

-Kryeni zbutje në suva me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose RASOMARC 9500150 në varësi të llojit të sipërfaqes.

-Aplikoni një shtresë astar akrilik me bazë uji IDROFIS 4700006 ose astar të mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.

-Aplikoni një-dy shtresa DECORFOND 3880019, të bardhë ose të pigmentosur, për të arritur një sipërfaqe homogjene ideale për aplikimin. Nuk këshillohet përdorimi i astarëve të tjerë.

-Vazhdoni me aplikimin e EASY_ART siç përshkruhet në udhëzimet për aplikim.

Sipërfaqe druri të fortë ose në kompensatë:

-Zmeriloni lehtësisht për të larguar fibrat e ngritura të drurit.

-Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës traspirante/tempera dhe zmeriloni të gjithë sipërfaqen e ljer.

-Largoni rezinën e pranishme me diluentin e përshtatshëm.

-Stukoni parregullsitë me stukon në pastë (pastroze) TAMSTUCCO 9400006 ose WALL STUCCO 9100019.

-Në sipërfaqe të pastra dhe të thara aplikoni 1-2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE seri 335 të bardhë ose të pigmentosur.

-Vazhdoni me aplikimin e EASY_ART sipas mënyrave të aplikimit të përshkruara në udhëzime për aplikim.

MEMENDJE në trajtimin e drurëve të pasur me taniinë. Për të reduktuar formimin e njollave të errëta aplikoni astarin UNIMARC PRIMER ANTITANNINO kod. 3080001/0019.

Sipërfaqe në material plastik (PVC):

-Zmeriloni sipërfaqen lehtësisht për ta ashpërsuar/qërruar.

EASY_ART

FINITURË DEKORATIVE PËR BRENDA ME EFEKT METALIK
seri 381

-Hiqni yndyrmat/vajrat me dylentën e përshtatshëm dhe pastroni sipërfaqen.
-Në sipërfaqe të pastër dhe të thatë aplikoni 1-2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE seri 335 të bardhë ose të pigmentosur.
-Pas të paktën 6 orësh aplikoni 2 shtresa EASY_ART.

* (Hollimi i astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqje specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

UDHËZIME PËR APLIKIM

Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

Lagështira relative e ambientit: <75%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

Lagështira e sipërfaqes: <10%
-Mjetet: rrul qimeshkurtër, pinel, sfungjer.
-Nr i shtresave: 2
-Hollimi: me ujë max 10%.

Mënyra e aplikimit:
-Aplikoni EASY_ART, në sfond të thatë, me rrul qimeshkurtër duke hapur produktin në mënyrë uniforme.

Pasi thahet shtresa e parë, aplikoni një shtresë tjetër EASY_ART me pinel ose sfungjer në varësi të efektit përfundimtar të dëshiruar.
-Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.
-Pastrimi i murit: pas të paktën 20 ditësh me ujë.
-Shkalla e mbulimit: 4-6 m²/l në 2 shtresa në varësi të aspektit të dëshiruar dhe i referohet sipërfaqeve lisho dhe mesatarisht absorbuese. .
Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqje specifike.

NGJYROSJA

Produkti është i disponueshëm në ngjyra të gatshme, të përdorshme edhe si baza tintometrike, argjend (0070), alumini (0170), flori (0190).

Ngjyrosja mund të realizohet nëpërmjet Sistemit Tintometrik Marcromie.

Për më tepër ngjyrosja mund të realizohet edhe me kolorantët COLORADO seri 548.

Në rastin e përdorimit të prodhimve të ndryshme, këshillohet përzjerja e tyre për të shmangur ndryshime të vogla në tonalitete.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. A/I: bojë për efekte dekorative (bazë uji): 200 g/l (2010)
EASY_ART Përmban max: 200 g/l VOC
Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në ambient. I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta. Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët. Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën.
Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren.
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Finiturë dekorative për brenda me efekt metalik.
Aplikimi, në sipërfaqe të brendshme të predispozuar për veshje (rivestimento) murale dekorative EASY_ART seri 381, me bazë kopolimer akrilik në emulsion ujor, në të paktën 2 shtresa sipas rrezes së përcaktuar dhe efektit final të dëshiruar.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.